



Republika e Kosovës
 Republika Kosova – Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës
 Opština Priština – Municipality of Prishtina



Në bazë të nenit 21, 22, 44 dhe 50 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, nenit 17, pika “d” të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, dhe nenit 15 pika “d” e Statutit të Komunës së Prishtinës Nr.110-391 dt. 25.02.2010, Drejtoria e Urbanizmit e Komunës së Prishtinës, duke vendosur sipas detyrës zyrtare, me datë 12.11.2021, merr këtë:

V E N D I M

PËR KORRIGJIMIN E Pjesës Grafike, E BASHKANGJITUR NË AKTIN ADMINISTRATIV
 “VENDIM PËR CAKTIMIN E KUSHTEVE NDËRTIMORE” 05 NR. 350/02-221666/20 DT. 20.05.2021

I. Korrigjohet pjesa grafike, “Plani i situacionit – zgjidhja urbane” e aktit administrativ “Vendim për caktimin e kushteve ndërtimore” 05 Nr. 350/02-221666/20 dt. 20.05.2021, i kësaj drejtorie, i lëshuar në emër të pronares Bahtie Hyseni, nga Prishtina, sipas kërkesës nr. 05-350/02-221666/20 dt. 03.12.2020, për hartimin e dokumentacionit ndërtimor/projektit kryesor për ndërtimin e ndërtesës afariste, me etazhitet B+P+2, në kuadër të parcelës kadastrale nr. 01533-0 Zona Kadastrale Bërnice e epërme në Prishtinë në kuadër të PZHU-së.

II. Ndryshimi i pjesës grafike “Plani i situacionit - zgjidhja urbane” ka të bëjë me korrigjimin e gabimit të gjeodetit në inqizimin e dorëzuar në dokumentacionin për aplikim për “Kushte Ndërtimore dhe zëvendësimin me “Planin e situacionit – zgjidhjen urbane” të korrigjuar me dispozite urbanistike të objektit me parcelë kadastrale në Sistemin Koordinativ KOSOVAREF 01”. Situacioni poashtu ka pësuar ndryshime në qasjen e automjeteve prej rrugës Prishtinë-Podujevë, qasjen e këmbësorve dhe pozitën e vendparkingjeve.

III. Para paisjes me Leje ndërtimore, duhet të prezantohet pëlqimi nga pronari i parcelës kadastrale 294-4 Z.K Bërnice e epërme.

IV. Ky vendim është pjesë e aktit administrativ “Vendim për caktimin e kushteve ndërtimore” 05 Nr. 350/02-221666/20 dt. 20.05.2021, dhe i njëjti do të prodhojë efekt juridik nga dita e miratimit të tij.

A r s y e t i m

Drejtoria e Urbanizmit e Komunës së Prishtinës, me aktin administrativ “Vendim për caktimin e kushteve ndërtimore” 05 Nr. 350/02-221666/20 dt. 20.05.2021, i ka caktuar kushte ndërtimore pronares, Bahtie Hyseni, nga Prishtina, sipas kërkesës nr. 05-350/02-221666/20 dt. 03.12.2020, për hartimin e dokumentacionit ndërtimor për ndërtimin e ndërtesës afariste, me etazhitet B+P+2, në kuadër të parcelës kadastrale nr. 01533-0 Zona Kadastrale Bërnice e epërme në Prishtinë në kuadër të PZHU-së.

Pas aplikimit për Leje ndërtimore, ky organ ka vërejtur se në aktin administrativ të referuar, ka rrjedhur një gabim në pjesën grafike përkatësisht “Plani i situacionit - zgjidhja urbane” për shkak të gabimit gjatë inqizimit gjeodezik të parcelës kadastrale nr. 01533-0 Zona Kadastrale Bërnice e epërme. dhe sipas detyrës zyrtare, pas rishikimit të aktit të referuar dhe konstatimit për gabimet e rrjedhura, të njëjtat korrigjohen, sipas përshkrimit në pikën I të dispozitivit të këtij akti.

Bazuar në dispozitat ligjore të përmendura, ky organ vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

brenda afatit prej 30 ditësh, duke llogaritur nga dita e marrjes në dorëzim të këtij vendimi. Bazuar në vlerësimin nga kjo drejtori, ankesa do të shqyrtohet apo do të përcillet te organi epror – MMPHI-ja.

Ky vendim u printua në 4 (katër) kopje identike dhe i dërgohet: Aplikuesve/Investitorit, në dosje të lëndës 05 Nr. 350/02-221666/20 dt. 03.12.2021, kësaj drejtorie dhe Qendrës për shërbim me qytetarë.

Kopja elektronike i dërgohet: Drejtorisë së Pronës, Drejtorisë së Kadastrit dhe Drejtorisë së Planifikimit Strategjik dhe Zhvillimit të Qëndrueshëm.

**DREJTORIA E URBANIZMIT E KOMUNËS SË PRISHTINËS,
05 NR. 350/02-221666/20 DT. 12.11.2021**

Zyrtari,
Mejrushe Sejdullahu



U.D. Udhëheqëse e Sektorit,
Mimoza Berisha Prishtreshi



Drejtori,
Arđian Olluri



